

Ekskluzive

Ekskluzive | Plumbi depërton në oborrin e një familjeje në Prishtinë – po rrinin jashtë kur u qëllua drejt shtëpisë, bastiset lokacioni i ahengut



Sinjali.com

31 Korrik 2026 08:29



Një incident i rrezikshëm me armë zjarri ka ndodhur mbrëmjen e së enjtes në fshatin Hajvali të Prishtinës, ku një plumb goditi derën e një shtëpie, derisa familja ndodhej në oborr.

Sinjali mëson se viktimë e rastit është Y. Gashi, 35 vjeçar.

Sipas burimeve, ngjarja ka ndodhur rreth orës 22:20 në rrugën “Drenova”. Ankuesi ka deklaruar se ishte duke qëndruar në oborr së bashku me familjarët, kur dëgjuan një krismë të fortë. Pasi u afrua te hyrja e shtëpisë, ai vërejti se një predhë kishte goditur derën, duke dëmtuar edhe pllakat pranë hyrjes.

Pamjet e kamerave të sigurisë, sipas ankuesit, ngritën dyshimet se të shtënat kishin ardhur nga një aheng familjar që po mbahej në një shtëpi në rrugën “Ulëza”, përballë shtëpisë së tij.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitë relevante të Policisë, hetuesit dhe krim-teknikët, të cilët kanë sekuestruar fragmentet e predhës si prova materiale.

Me urdhër verbal të Prokurorit të Shtetit, është bastisur shtëpia nga e cila dyshohej se ishin shkrepur të shtënat. Gjatë kontrollit nuk është gjetur armë, ndërsa është sekuestruar sistemi i incizimit (DVR) për ekzaminim.

Lidhur me rastin, në stacion policor janë shoqëruar **Enver Hajrizi**, 54 vjeçar dhe **Driton Hajrizi**, 49 vjeçar. Burimet bëjnë me dije se ndaj tyre është iniciuar një rast tjetër, ndërsa pas procedurave janë liruar në procedurë të rregullt.

Policia ka iniciuar rast për veprat penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, ndërsa hetimet për identifikimin e personit që ka shkrepur armën janë në vazhdim.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

ekskluzive

Familje

plumbi


Sinjali

Të tjera:



Pritje deri në një orë e gjysmë në kufi, më e ngarkuara pika në Jarinjë

Kosovë



BE-ja akuzon Temu-n për mosbashkëpunim në hetime – kompania kineze i mohon...

Teknologji



“Game Over” për “spiunin” e Iranit: Arrestohet në Qipro, pritët të ekstradohet n...

Evropë

Ndalohen punimet në dy kantiere ndërtimi në Prizren dhe Suharekë, rrezikohej jeta e...

Siguri

Ushtria shqiptare merr 40 mjetet e para taktike të prodhuara në vend

Shqipëri

Kuvajti rrëzon dronët iranianë që synonin objekte ushtarake, raportohet vetëm për...

Botë

Sa janë rezervat e ujit në Kosovë? Badoci dhe Batllava në gjendje të menaxhueshme

Kosovë

Rritet fronti kundër FIFA-s, edhe Azia kundërshton projektin e Infantinos

Futboll

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera